

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

814-1  
N53

Rudolf Marku



poezi

---

814-1  
M 35

RUDOLF MARKU

# RRUGA

poezi



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## P A R T I

Ka diçka nga luftërat në çdo moment të jetës sime,  
përderisa dhe ti ke lindur në luftë.  
Armiqtë e tu dhe armiqtë e mi janë,  
Deri në vdekje përleshem, gjakosem, ngrihem përsëri  
dhe eci,  
Shkund pluhur me duart e mia dhe me duart e tua,  
Përleshem me të tjerët, me armiqtë e tu, me një pjesë  
të vetvetes.

Nga kjo bëhem më i mirë,  
përderisa ti linde pér një botë më të mirë,  
Kundër shëmtimit të urisë, kundër shëmtimit të  
zotërinje të kënaqur.  
Kundër shëmtimit të gruas së përbuzur gjatë gjithë  
shekujve,  
Kundër nënshtimit të verbër dhe mashtrimit të  
njerëzve.

Ka diçka'nga lartësitë në çdo moment të jetës sime,  
përderisa ti je lartësia më e madhe.  
Ngrihem në qiellin e kohës sime dhe prapë në tokën  
time jam,  
Shikoj planimetrinë e ditëve, Ballshin, Metalurgjinë,  
Xhuxhraxhuxhë më të vegjël se asnijëherë tjetër më  
duken  
Burokratët, fodullët.

Nga kjo them se gjithçka që është tek ti  
eshtë edhe tek unë;  
Këngët e tua janë në këngën time,  
Në shtegballin tim është rruga jote pa udhëkryqe, e  
drejtë.  
Në përshëndetjen time të përditshme është përshëndetja jote  
Dhe në çastet e tua dita ime merr trajtë,  
merr jetë.

## FJALËT E METALURGJIKUT THËNË ME RASTIN E VIZITËS SË SHKRIMTARËVE

Mirë se erdhët, shokë shkrimtarë, mirë se erdhët  
të gjithë,

Ne jemi tanët,  
Shokë dhe miq!

Disa nga ju tek unë kanë punuar  
Me muaj dhe vite me radhë,  
Të tjerët miqësishët më kanë dërguar  
Një libër — poemë apo dramë.

Romanet qhe vjershat tuaja i kam lexuar  
Nën abazhurin e dritës së çelikut të shkrirë.  
(Natyrisht, do mbuloja me ulërima sirenash  
Fjalët — «8 rrrokësh apo varg i lirë?»)

Ka vepra, pa dyshim, që më ngjasin mua,  
Romane, dhe poema me hapësirë të madhe,

Atje gjithë punëtorët e reparteve të mia  
Mund t'i zërë hapësirë e gjerë e fjalëve.

Do flasim gjerë e gjatë për Shqipërinë,  
Për oxhaqet e mia të ëndrrave proletare,  
Pas kësaj s'ndodh që nga oxhaku i librave  
Të dalë vetëm tymi i duhanit të shkrimtarëve.

Tek veprat tuaja, si në oxhaqet e mia,  
Del e lirë frymëmarrja proletare,  
Me trupin tim gjigand atje do të rri  
Në hapësirën e gjerë të fjalëve.

Dhe tjetri biseqë selin e njëjtin  
Dëgjoune të mëpërmëtë është përgjithësia  
Gjatë i kryesë bisaqë me dëgjimin  
Gësimi me gësiminë pasti me pell

Gjeti bisaqë që mund t'i fitojë shpëtimin  
**U R A T**  
Zgjedhur i përpjekë se nuk e fitojë  
Hizpërshet përfshi që nuk e fitojë

Kur armiqjtë i knin të mundur,  
Ata hidhnin urat në erë.  
Që të mos bashkohej qyteti me qytetin,  
Që të mos lidheshin njerëzit më njerëz.

Dhe vërtet, qëllonte për një kohë,  
Kur urat ishin hedhur në erë,  
Ca njerëz rrin në një anë,  
Në anën tjetër rrin të tjerë.

Por prapë njerëzit thërrisin njëri-tjetrin  
Me zë të lartë që kalonte mbi lum,  
Dhe fjalët bëhen njerëzit — ura,  
Emrat e njerëzve — ura në muzg.

Kështu krijueshin ura më njerëzore,  
Kur njeriu thërriste njerinë:  
— O filani, brë, i biri i filanit,  
Zanin tem a po e ndin?

Dhe njeriu prapë zërin e njeriut  
Dëgjonte në mbrëmje nga bregu matanë,  
Qyteti lidhesh prapë me qytetin,  
Gëzimi me gëzimin, halli me hall.

Sot prapë armiq të tjerë shfaqen,  
Edhe të mundur një ditë ikin.  
Zakoni i hedhjes së urave në erë  
Rishfaqet tek ata me forcën e ritit.

Vendosin minat — hermetizëm,  
Vendosin minat — subkoshience,  
Që të mos bashkohet qyteti me qytetin,  
Që të mos lidhen njerëzit me njerëz.

Pëlcitja e tyre do të ishte fatale,  
Pëlcitja e tyre do të ish me rrënim,  
Do të krijoreshin me mijëra brigje,  
Veç që njeriu të mos lidhesh me njerinë.

Por urat ndër shekuj janë ngritur tek ne  
Nga gjuha njerëzore, në tokën tonë,  
Dhe mbi këto ura ka thirrur shqiptari:  
— O bre, filani, a po më ndëgjon?

## P U N A

Tek dhoma ime vijnë zërat e punës,  
Çekiçi i këpuçarit që troket fort,  
Thirrje muratorësh, përplasje kovash,  
Uturima makinash që zhduken në sfond.

Tek dhoma tjetër pleqëria e nënës  
Ngadalë-ngadalë një lule qendisë.  
Në një qytet tjetër, një vajzë e bukur  
Stofra dhe basme i jep Shqipërisë.

Ja fqinji im, me grepin e peshkut  
Niset drejt lumit (s'rrihet në shtëpi),  
Kallinjtë e fundit të grurit në fusha  
Mblodhën në peisazhin e verdhë fëmijët.

Ja puna, e vjetër, e mençur; e rëndë,  
Lë gjurmët e saj dhe mbi letrën time,  
Çekiçi i këpuçarit troket tani më fort  
Mbi fjälët, mbi rima dhe ritme.

## NDEZËSI I FENERËVE

Në kalldrëmet e vjetra vinte zhurma tak-tuk, tak-tuk  
(Fenerndezësi nallanet prej druri kërciste).

Në qytetin tonë ai në gjashtë fenerë të vegjël  
Dhe në zemrat e njerezve një dritë të largët ndizte.

Fëmijët, pas kësaj, dilnin në oborre,  
Me një top lecke thërrisin tërë gaz  
Nënët tonë na kërcënonin me zë të çjerrë  
Se do të na ndëshkonin në darkë.

I mbaj mend ato pesë gjashtë fenerë të vegjël  
Në qytetin tim verior, ku mbrëmja vinte e frikshme,  
Dhe fenerndezësi, ndonëse nallanet e tij prej druri  
Nuk të linin të besoje se ai vërtet Prometeu  
ishte.

I mbaj mend të gjitha këto  
Fenerndezësin, qytetin me krisma, magjira,  
Ato zhduken në sfondin ujor të hidrocentraleve  
Që ndezin llampa dhe mendime me mijëra.

Si do spokësi këtë ati gjumë  
Pashqetër është që pësht bazi

Dhe kështu, të treguar tonë  
Historiunë gjithnjë e ka bërë  
Por ajo s'jep me rëndësi gjoksi  
Nga i tillësia e gëpindës sëri i asaj

## GJUHA E HISTORISË

Shiko mirë në tokën tonë,  
Në themel që sapo u hapën,  
Së bashku me baltën dhe llucën  
Statuja edhe heshta dalin.

Ja, në shtëpinë ku banoj,  
Pothuajse njëzet metra larg,  
Shtrihet fare qetësisht,  
I Gjergj Kastriotit varr.

Dhe në rrugët ku kaloni,  
Dhe gjatë ditëve dhe në darkë,  
Pa e ditur mbi rrugën Egnatia  
Keni shkelur legjione romakësh.

Nga ky shi që bie i lehtë;  
Tek kalon qetësisht në rrugë,

Patjetër që do bësh pyetjen  
Si do shkojë këtë vit gruri?

Dhe kështu, në tokën tonë  
Historinë gjithkund e ke pranë,  
Por ajo s'flet me rënie gjoksi,  
Zëri i njerëzve është zëri i saj.

## CHAPITRE HISTORIQUE

## KUR NË KILI DHE NË VENDE TË TJERA

Kur në Kili dhe në vende të tjera,  
Kundërrevolucioni kthehej në fashizëm sërish,  
Së bashku me komunistët dhe punëtorët  
Edhe poetët i vrisnin  
Të pështetur pas murit, egërsisht.

Gjaku i njerëzve të pastër derdhet në botë  
Por unë desha t'ju themi dhe diçka tjetër:  
Eshtë në Kili Nikanos Parra,  
Poet i antipoezisë në atdheun e tij.  
Gjatë ditëve të kundërrevolucionit atë s'e vranë  
Dhe vetë ai nuk vdiq  
Dhe as u kujtua ta ngasë me dorë njeri.

Gjaku i njerëzve të pastër derdhet në botë  
Gjatë ditëve të kundërrevolucionit atë s'e vranë  
Gjatë ditëve të kundërrevolucionit atë s'e vranë

## KUR NË KU IN TË TIRVY PLAKAT

Në praguni e shtëpiveltona,  
Mbështjellërd me shami të zezë,  
Për të gjallët udhe të vdekurit  
Me gjysmë zëri bëjnë bisedë.  
Janë plakat e vendit tim  
Mbushur plotpërplot me jetë,  
Në fytyrat e rrudhosura  
Hidhërimin e kanë të qetë.  
Mbështjellë me shami të zezë  
Gjithë çfarë pani ato në jetë,  
Edhe nyje e shamisë  
Posi gojë e kyçur s'flet!  
Porse dihet, flasin rrudhat,  
Gojë të hapura ato janë,

Kohëra, ngjarje dhe njerëz  
Nga rrudhat e tyre dalin.

Burra t'urtë, fytyrëvrenjtur,  
Nëpër luftëra përcëlluar,  
Ja, ku shfaqen përmbi rrudha  
Tërë plagë rivijëuar.

Ja dhe burrat tej kurbetit,

Ja dhe jetë që pérplaset,

Në fytyrën eshtëfortë

E gjithë koha e tyre shfaqet.

Dhe kur njëra tym nga goja

Nxjerr, duhan kur pi me llullë,

Ja ku shfaqen në mes tymit

Tek digjen shtëpitë rrënuar.

Janë plakat e vendit tim

Mbushur plot përplot me jetë

Mbajtur në një shkop prej druri

Dhe tek koha qetë e qetë.

Mbështjellë me shami të zezë

Dhe tek koha jonë mbështetur,

Bëjnë biseda jetësore

Për të gjallë e për të vdekur.

## KËNGË PËR FËMININË...

1.

Në fëmininë tonë bota e madhe ishte e shqetësuar,  
Këtë e ndienim në rrudhat e shtuara tek prindërit  
tanë,  
Këtë e ndienim në shaminë e merakosur të nënave,  
Në lodrat që filluan shpejt t'i harrojmë.

Dëgjonim me kureshtje bisedat e të rriturve,  
Asgjë e jashtëzakonshme s'kish ndodhur,  
bota s'ish përmbysur,  
Përrallat shqetësimit të baballarëve filluan t'u  
ngajnjë,  
Shamisë së merakosur të nënave  
dhe ballit të tyre të ngrysur.

2.


Na dukej sikur me vite e prisnim këtë ndryshim,  
Sepse kishte pasur me kohë diçka reale dhe të  
zhveshur  
në fëmininë e hershme,

Në historitë e reja që dëgjonim nga prindërit tanë  
Na kujtohej përplasja e lugës në pjatën kuti-teneqeje.

Kish pasur me kohë diçka reale dhe të zhveshur në  
fëmininë tonë,  
Diçka që ngrihej mbi çdo fantazi, që të kujtonte fjalën  
bukë,  
Diçka që çuditërisht nuk na i pakësonte përrallat dhe  
ëndrrat,  
Diçka që shprehej në gjëzimin tonë të çuditshëm, kur  
thonim:  
— Sonte ka film me luftë!

### 3.

Ne dhe gjithnjë më tepër kujtonim se kish ardhur  
koha për të dalë jashtë oborrit tonë;  
Duhej të dilnim në botën e madhe, të linim fëmininë.  
Varkat prej letre na u dukën të vockla, xhuxhma-  
xhuxhe, të dhembshura  
Kur pamë banijet sovjetike të iknin në Vlorë, në  
Shëngjin.  
Dhe ne kuptuam, kish ikur përgjithmonë fëminija,  
Pa lot, pa xhestë të mëdha, me një përshtëndetje të  
lehtë,



Kishikuri fëminija dhe lart në vend të balonave prej  
Fjala e huaj-bllokadë dridhej në erë.

Dhe vetëm atëherë kuptuam ç'kishin dashur të na  
Kuptuam atë që ndienim se ashtu duhej të ishte në  
Kur tradhtia e madhe e botës u shfaq në fytyrën e  
Ne kuptuam që përrallat nuk kishin më kuçedra, por  
Hrushovit,  
njerëz të gjallë.

4.

Kështu u rritëm ne në botën e madhe,  
Jeta jonë që në fillim ishte reale si shkëmbi i gurtë,  
Jeta jonë që në fillim i bëri secilit nga ne pyetjen:  
«S'a të drejtë ka çdonjeri prej nesh për t'u strukur?»  
Ëndrrat tona nuk ishin të mbushura me fantazma,  
Dhe as netët nuk i deshifruam në fundin e filxhaneve  
të përbysur,  
Dhe as në duart e shtrira, në udhëkryqet e vizave të  
Atje të hütuar në udhëkryqjet të qëndronin vetëm  
fantazmat.

Jetaljonë që në fillim ishte reale si shkëmb i gurtë  
Poshtë fjalës së huaj bllokadë që dridhej në erës  
Ja, në qellin e madh të kohës sime, sipër vetëtimave;  
U shfaq si besim i popujve buzëqeshja e shokut Enver.

5

Dhe vetëm atëherë ne kuptuam më mirë se asnjëherë  
Në një kohë madhe kishim ardhur ne,  
Në një kohë kur frynin erërat e ftohta të tradhtisë së  
madhe,  
Dhe bota të vinte dorën mbi sup, e të pyeste  
miqësisht:  
— Çfarë dhe?

Në një kohë të madhe, kur gjërat e vogla, nostal gjitë,  
psherëtimat,  
Ngjanin si varkat prej letre në krahasim me anijet që  
iknin në Vlorë,  
Në një kohë të madhe, kur revolucionet dhe ngjarjet  
e mëdha  
I japid secilit nga ne të drejtën të mos harrojë.

Në një kohë të madhe me erëra të fuqishme  
revolucionesh,  
Që fëmininë tonë e ngritën lehtë si një balonë në  
re,

Dhe bota e madhe të ve dorën në sup duke qeshur,  
Dhe ashtu duke qeshur të pyet seriozisht: — Cfarë dhe?  
Në një kohë të madhe, me sekretin e rritjes së  
papritur,  
Në zhveshjen e fantazisë fëminore, si në kallëzimet e  
prindërve tanë,  
Si besimi i popujve në buzëqeshjen besnikë të  
Enver Hoxhës,  
Ashtu u shfaq në botën e madhe jeta jonë.  
— Cisig qjet

Në kohë të madhe kur gjithë vajza merrin  
Ngjashme me vajza tjerë, këto moshësasitë me sulje të  
ikunë të Vlorës  
Në kohë të madhe kur lezonigjet e dhjetorit  
e mbyllin  
I lëshin seçillë që është e përcollë

Ai që u vra ditën e çlirimit  
Besonin se shpërme tëp. u lejën i tregimit  
Kurse si tiflologësi është që si i personit  
Njëdë nuk shpëtë sështë që si dëshmi

## AI QË U VRA NË DITËN E ÇLIRIMIT

Ai që u vra ditën e çlirimit  
Ty nuk të ka parë, burokrat, s'të njihte.  
Luftonte në mal ai që u vra  
Dhe s'e mori plumbi ndejtur mbi karrige.

Ai që u vra ditën e çlirimit  
Dha jetën e tij për revolucionin  
Jo që ti të ulesh ashtu qetë e qetë  
Dhe të ndihesh mirë kur soba bën nxeh të.

Ai që u vra ditën e çlirimit  
Nuk mori në mal me vete kolltukë.  
Ndejti mbi një gurë, dhe ashtu ëndërrroi  
Një jetë më të ndershme, një jetë më të urtë.

Burrë edhe ca burrë, edhe ca karrige  
Në peshën e letrës ti beson tepër.  
Ai që u vra ditën e çlirimit  
Vetëm për duhan kërkonte ca letër.

Ai që u vra ditën e çlirimit  
Besonte aq shumë tek njeriu i thjeshtë,  
Kurse ti thjeshtësisë s'ke si i beson  
Ngaqë nuk është zyrë dhe as sobë e nxeh të.

Ai që u vra ditën e çlirimit  
Të mëson një gjë, burokrat i shkretë,  
Gjeje gjysmën tënde të humbur me kohë  
Mes njerëzve të thjeshtë.

Ai është që nuk është që nuk është  
Të mëson një gjë, burokrat i shkretë,  
Gjeje gjysmën tënde të humbur me kohë  
Mes njerëzve të thjeshtë.

Ai është që nuk është që nuk është  
Të mëson një gjë, burokrat i shkretë,  
Gjeje gjysmën tënde të humbur me kohë  
Mes njerëzve të thjeshtë.

Ai është që nuk është që nuk është  
Të mëson një gjë, burokrat i shkretë,  
Gjeje gjysmën tënde të humbur me kohë  
Mes njerëzve të thjeshtë.

Burra e shpejtë e përfshirë e shpejtë e përfshirë  
Në besën e jetës së përsor të përfshirë  
Ai është që nuk është që nuk është  
Vetëm burrë qëndruan kërkohën e jetës

## M B I S H T E T E T

Shikojmë gjurmët e mbishteteve,  
Vijnë nga prehistoria e kohës së tyre  
Si përbindësha me dy kokë,  
Real, jashtë q'do mitologjje.

Mbishtete që mburren në Angolë, në Spanjë,  
Që shesin mend në Çekosllovaki, në Egjipt,  
Ja ku u shfaqët, për ironinë e popujve,  
Me paradoksin e mbinjeriut.

Vëmë veshin në botën e madhe,  
Edhe dëgjojmë zhurmërimin fjalë.  
Shpërthimet bërthamore të amerikanëve  
Shkaktuan tërmelin në Guatimalë.

Ja ku shfaqen gjurmët e mëdha  
Në një kërcënim, në një buzëqeshje,  
Aeroplani i Kizingerit u ul në Liban  
Si i dërguari i Zeusit tek Prometeu.

Ardhur nga prehistoria e kohës së tyre  
Ndeshen me kohën tonë të madhe,  
Plagët e tyre: inflacionet,  
Zemërimi i popujve edhe skandalet.

Tërbohen nga plagët dhe sulen prapë  
Futur në tanke, futur në libra  
(Në një zënie me burokratët  
Ndjenë dhe jehonën e sulmit të tyre.)

Mbishtetet që shfaqen në kohën tonë  
Me dy kokë — Nju-Jork dhe Moskë.  
Ja ku shfaqet si tmerr i tyre  
Libri i 19 i Enver Hoxhës.

Shikojmë gjurmët e mishteteve  
Në Çekosllovaki dhe në Egjipt.  
Plagët e tyre: zemërimi i popujve  
Dhe paradoksi i mbinjeriut.

## DASHURIA, SI KOHA

Dashuria, si koha, pa fillim, pa mbarim,

Si misërat në fillimin e korrjes së tyre:

Dashuri që mund të shuaj urinë

Dhe nga kokrrat e saj misëra të tjerë të mbijnë.

Nuk jam sentimentalist që të besoj më mendjelehtësi  
Në dashurinë e fundit, në dashurinë e fillimit,  
Po ato buzë, po ato sy, po ai gjëzim i dëshiruar,  
Po ajo pritje në perëndimin e fundit të diellit  
Apo në paralindjen e agimit.

Dashuria, si koha, e thjeshtë dhe madhështore,

E prekshme si kjo vajzë që ka emrin e saj.

Dashuria, si koha, është dhe e përjetshme

Si fëmijët që do të lindin nga kjo vajzë.

Dashuria, si koha, dhe ti ecë pranë saj

Dhe kupton kaq lehtësisht praninë e gjithë ditëve:

Dashuria, si koha, kur ti ndien se si ajo

U jep emrin e saj të gjitha gjërave.

## NDËRTUESIT E FABRIKËS/SË LETRËS

Nga fusha i thërritën  
(Punëtorë ndërtimi duheshin dhe më tepër)  
Ti, dhe ti, dhe ti, u thanë,  
Do ndihmoni, në ndërtimin e fabrikës së letrës.  
Në ditët e para hutimi kalonte nga njëra dorë në tjetrën,  
Duart e tyre të mësuara me grurin dhe misrin  
Më pas do të mësonin që të jap fruta  
dhe bota e hekurt.

Kështu filluan punën në fabrikën e letrës,  
Ata kishin qenë të gjithë bujqë mirë.  
Fshatarët më pleq, dikur të menduar  
Gjithë jetën e tyre kishin tymosur duhan  
me letër të nxirë.  
Por u mësuani me ngjitjen në skela,  
Shtyllat e hekurta  
si pemë gjigande u dukeshin ndonjëherë,

Bota metalike e motorëve të komplikuar  
një erë të mirë misri dhe gruri  
filloi të bjerë.

Se ndodh shpesh që punëtorët ngjiten në muret e larta  
Për të parë grurin se sa është rritur,  
Dhe vetë gruri afrohet kaq shumë  
sa që përkëdhelet me muret e fabrikës.

Prandaj gruri jashtë mureve rritet  
që klasat të rrisin më shumë njëra-tjetren,  
Si do të shkojë këtë vit gruri?

Shkruajnë gazetarët pikërisht mbi letër.  
Fabrika i rriti bujqit e mirë,  
u dha atyre kuptimin e klasës.

Ja, ajo u thotë atyre me zë prej nëne:  
«Letër nuk jap për burokratët!»

Kështu u bënë ata punëtorë,  
hipur në skelat e botës së hekurt,

Por dashuria për grurin dhe misrin  
u shtua më tepër.

Sigurisht, kur ata në mes të maleve  
dhe për fushat e bucura flasin,  
diçka të rëndësishme ndiejnë ata,  
diçka jashtëzakonisht të mençur,  
rritjen e klasës.

Bon matsejje e moforeja te komplikuar  
Uje eni li mija minni dje għiġi

Ulli li p'jew

Se u sibek spop opaq lu qiegħi ja nsew u is-sa  
Bipax li qed tibbi se ja għixx

## ÇDO NJERI MUND TË SHKRUAJ DIÇKA PËR DASHURINË

Çdo njeri mund tē shkruaj diċka pér dashurinë.

Ja, mbyll sytē dhe kujto  
Dy buzët e saj,

dy sytē,

dhe flokët e saj,

Dhe duart e zgħatura nē hapësirë,  
Tē sħturejha pér ty ngelin ato.

Por prapë njeriu mbi fletën e shkruar  
Pérse do tē ndieej

se diċka mungon?

Kerrusset mē tepér  
mbi fletën e shkruar,

Pastaj ngadalę<sup>1</sup>  
diċka kujton.

Dikush troket, krejt befasisht  
Leħte e leħte nē fillim troket,

Pastaj trokitjet rriten dhe rriten,  
Rrëzohen dyert,  
dritaret krejt.

Eshtë jeta jashtë

ditë edhe ngjarje,

Frymë ere lëshojnë dhe frymë stuhie,  
Hap portën,

njeri i kërrusur mbi letrën e bardhë,

Pa dashjen tënde

në vend të llozit, në portën e dhomës  
ke vënë një varg dashurie.

Vargjeve të tua diçka u mungon.

...Dy sy, dy buzë

dhe flokët e saj....

Mund të vijë një njeri tjetër

dhe mund të pyes,

edhe pastaj?

Si mund të rrijë jashtë portës së vargjeve,

Dhe Kili,

dhe grushti i ndezur flakë?

Fashistët u ringjallën në botë përsëri?

Kapitali gëlltit

dhe ditë

dhe natë?

Shtete të tëra të sëmurë rëndë

ecin udhëkryqeve ngadalë,

Sigurisht nuk duan tē dinë ato  
dy sy, dy buzë  
dhe flokë tē rrallë..

Mund tē ndërpritet krejt befasisht  
Biseda me tē dashurën në telefon  
Dhe një zë i njojur mund tē thotë:

«Në një shtet revolucion..»

Por s'mund tē thuash më pas, ngadalë,  
Ngatërruan linjën,

centralistja pati faj...

Mat pulsin e botës

dhe ritmi i jetës,

Futet në dhomë dalngadalë.

Jeta ulet në karrigen e dhomës sate

pa drojtje,

pa turp,

si në shtëpi tē saj.

Dhe ti për diçka do kujtohesh,

në mendje diçka e njojur tē vjen,

Stërgjyshërit tërë plagë,

eshtrat e mprehta,

dhe ato në trajtë e shpatës.

Botë e shqetësuar në fundin e shekullit njëzet,  
Frymëmarrja e ngjarjeve,  
në dhomën tënde mespërmes,  
Dhe vetëm tani ti mbyll sytë,  
diçka të bukur kuko:

### DITAT E NGAZURA

Dy buzë,  
dy sy  
dhe flokët e njoitura,  
dhe duart e zgjatura në hapësirë,  
drejt teje vijnë përsëri ato.  
Dhe vetëm tani diçka nuk mungon,  
Thuaj më vete ngadalë:  
....Jeta është në dhomën time  
Me hapat e para të saj.

## DRITAT E NDEZURA

Fqinji im u kthye vonë në shtëpi,  
Drita në shtëpinë e tij nuk ishte shuar,  
Fqinji im është njeri i mirë  
Mund të thoni ju — jo dhe aq i mësuar!

Njerëzit e shtëpisë së tij nuk bien të flenë  
Pa u kthyer nga kantieri ai.  
(Këto ditë në kantier ka shumë punë  
Dhe vonë kthehet çdo natë në shtëpi.)

Ja, edhe sonte u kthye vonë në shtëpi.  
Dhe vonë drita në shtëpi u shua  
Dhe unë tani ndeza një tjetër cigare  
Për fatet e njerëzve duke menduar.

Për dashurinë e tyre, për besnikërinë e tyre  
Ka njerëz në botë që në gjëra të tillë nuk besojnë.  
Pavarësisht nga ata, drita do të rrijë përsëri  
ndezur,  
Nesër mbrëma fqinji im prapë do kthehet vonë.

Fjalët e tij  
 Në të cilat përgjysmë lënë ndonjëherë,  
 Një xhaketë mbi supe hedhur pa kujdes  
 Në çdo hap ëndrra përderisa ka njerëz.  
  
 Fjalët e tij  
 Në të cilat përgjysmë lënë ndonjëherë,  
 Një xhaketë mbi supe hedhur pa kujdes  
 Në çdo hap ëndrra përderisa ka njerëz.  
  
**FJALËT E THJESHTA**  
 Në të cilat përgjysmë lënë ndonjëherë,  
 Një xhaketë mbi supe hedhur pa kujdes  
 Në çdo hap ëndrra përderisa ka njerëz.  
  
 Dhe vret mendjen netve, kokën kap ndër duar  
 Edhe kjo natë iku pa shkruar asgjë,  
 Pa thënë asnë fjalë iku dhe kjo natë,  
 Minuta dhe orë që s'do kthehen më.

Dhe harron papritur mijëra fjalë që u thanë  
 Ashtu nën buzë a nën strehë shtëpie,  
 Fjalë kaq njerëzore, mençuria vetë  
 Ashtu nën buzë lehtë e lehtë rrëshqet.

Dhe harron papritur, mbi këtë tokën tonë  
 Njerëzit punëtorë kaq afër i ke,  
 Në jug, në veri, ata janë pranë teje  
 Dhe zemra me ritmin e tyre të rreh.

Dhe harron papritur fjalët aq të thjeshta,  
 Të cilat përgjysmë lënë ndonjëherë,  
 Një xhaketë mbi supe hedhur pa kujdes  
 Në çdo hap ëndrra përderisa ka njerëz.

Ëndrra kaq të bukura, mund edhe përpjekje,  
Ëndrra që përbushen edhe shqetësime;  
Bota s'do kish peshë pa të gjitha këto,  
Si një lodër fëmije bota do të ngjiste.

Dhe vjen çasti pritur, dashuria e madhe  
E njerëzve puhëtorë futet në vargun tënd,  
Shqetësimi yt dhe shqetësimi botës  
Dhe brenda një fjale pranë e pranë zënë vend.

Q'vlenin para saj, në vende të largëta  
Historianët e shqiptarëve historiane e përdor  
Vendimi i mërisë së përdorimit të  
Njegur, jashtë e bëjnë në këtë spërma koke.

## GJAK I BUKUR LUFTE

Malësorët tanë dhe sot e kësaj dite  
Rreth e rrrotull koke mbajnë shami të lidhur;  
Sigurisht, kjo s'është çallmë otomane,  
Ky është fati i kombit, fati i tij i hidhur.

Malësorit i shfaqeje gjithmonë një plagë pushke,  
Mbi kurmin e tij do mbinte një plagë,  
Do të shfaqeje gjaku, gjak i bukur lufte  
Si tingull lahute rridhte ngadalë.

Dhe shamia e lidhur vihej përmbi gjak  
Porsi dorë e dhemshur mbi drunë e lahatës,  
Tek gjyshërit tanë mbinin gjithnjë plagë,  
Në kurmin e tyre gjak i bukur lufte.

Shami të lidhur rreth e rrrotull kokës  
Fati i kombit tim, fati i tij tragjik,  
Ç'vlenin para saj, në vende të largëta  
Njerëz të përkëdhelur, kapele republike?

C'vlenin para saj, në vende të tjera,  
Historianë që shkruanin historinë e botës?  
Vendi im tragjik, historia jote  
Ngelur krejt e gjallë në një shami koke.

## ÇYRK I BURKU LULIT

Mësuesit i shkollës shtipione u treguan  
Mbi Kurmin e illi që mëmatojte përsigjet  
Do të shkaktojë atij që përkushton  
Si t'u lënë ishte mundësia e dashurie  
Të përdorim e tij që përfundoi shqip  
Lori dore e qëndroni tjetri qëndron e fshatit  
Të përzgjidhët tani tëpërta ditën e përsigje  
Nës Kurmin e tave gjak i përkushto  
Shtimi i tij është tani e rrethuar kofços  
Fati i kompiti turi, tani i illi fshatit  
Qëllimi bësas së, që vendë i tij janë  
Njëqës i tij bësifqarët, përdore latupillit

## NË DIMËR PIKAT E SHIUT BIEN

Në dimër pikat e shiut bien,  
Tregojnë të fshehta, tregojnë ç'kanë parë.  
Por sa e vështirë për mua tani  
Të shkruaj diçka mbi letrën e bardhë.

Të them diçka të thjeshtë e të mençur,  
Diçka të zakonshme, që njerëzit e thonë.  
Ja, pikat e shiut si ditët rrëshqasin,  
Por prapë koha mban fytyrën tonë.

Të them se jeta mbi imtësitë,  
Mbi krahasimet për pikat e shiut  
Ngrihet reale dhe e përditshme  
Mbi vetëtimat jeta e njeriut.

Bien pikat e shiut të mëdha; radhë-radhë  
Dhe ernat që fryejnë diçka mund të thonë,  
Por në botën e madhe le të vemë veshin,  
Të dëgjojmë frysëmarrjen e revolucionit.

## MË MORI MALLIUPËR DETIN

Deti fryn një erë fëmijnie  
Edhe më shtyn kjo erë e lehtë,  
Një erë jodi që kujtesën më thërret  
— të vij në bregdet.

Mbi varka të përbysura shkoj të ulem,  
Se deti diçka pér mua do të nxjerrë,  
Guackat hapin kapakët vetvetiu  
Se s'duan të mbajnë të fshehta nga të tjerët.

Guackat tani kujtesën ma thërrasin  
...Ditë vere ishte, kur ne u takuam...  
Se deti na lidh, si dallgët me dallgë,  
me njerëzit që duam.

Të lëkura e qëndrave, por jo dës vësidi i është më i lirë se  
Dhe as nuk vësidi i bëjillësia depësë  
Gjegjimtë e tjerë është që shkruan tani  
Si jepimët e tundit më gjepjetën e fëmijëve që jetës

## KËNGË TJETËR PËR ARDHJEN E DALLËNDYSHEVE

Pemët lulëzuan,  
Fijet e barit u gjallëruan  
(Pranvera erdhi, kjo shihet qartë)  
Dhe në telat e telefonave  
Dallëndyshet erdhën nga vende të largëta.

Dallëndyshet, verës, nga Arabia vijnë;  
Nga vendet e nxehta, nga vendet e përrallave,  
Kështu na thonin ne më të vegjëlve  
Gjyshi, mamaja.

Tani, të rritur, shikojmë dallëndyshet që erdhën,  
Të nxira krahët,  
Kjo, padyshim,  
Të bën të mendosh  
Se ato vërtet nga Arabia vijnë.

Të nxira erdhën, por jo nga vendi i një mijë e një netve  
Dhe as nga vendi i përrallave dehëse.

Cicërimat e tyre na duken tani  
Si lajmet e fundit mbi grabitjen e lëndëve djegëse.

Prapë si dikur ulen mbi telat e telefonave,  
Por edhe mbi tela se si nuk duken më si atëherë.  
Tani telegrame të rëndësishme ngjarjesh u japin  
njerëzve  
Me morsin e përplasjes së sqepit mbi tel.

Ku ta dinim dikur se më dallëndyshet  
Nuk do i përkisnin botës së përrallave,  
Se dhe cicërimat e tyre mbi tela do bëheshin  
Rrëfim i vogël mbi kohën tonë të madhe?

## DHE THONË BUROKRATËT

Dhe thonë burokratët se revolucioni  
Vetëm atij a këtij i përket.  
Po të ish kështu, si mundej revolucioni  
Të kishte forcën e miliona njerëzve?

Dhe thonë burokratët se revolucioni  
Punëtorët janë, në erë, në shi.  
Por në detin mirëqenie, me fjalët polumbar,  
Burokratëtëndërrojnë të jenë në thellësi.

Dhe thonë burokratët se revolucioni  
Duhet të ketë frikë nga e bukura gjithmonë.  
Po të ish kështu, si ndodh atëherë  
Që më i bukuri nga të gjithë është revolucioni?

Dhe thonë burokratët se revolucioni  
Vetëm atij a këtij i përket.  
Për këtë ngre grushtin e klassës kontrolli punëtor  
Dhe mbi burokratizmin godet.

## M. T U T U L A N I

Fotografinë tënde kam në tavolinë,  
Dy sy të mëdhenj,  
Dy sy të zinj.

Kush tha se të vranë?

Në emrin tënd  
E dashura ime.

Këtë mund ta kesh ditur,  
Këtë mund ta kesh pritur,  
Prandaj dhe ke qeshur  
Atë natë që të vranë.

Në moshën tënde  
Mosha e jonë.

E qeshura pranë.

## NGATRITË E MEDHA K U J T M

Duke të njohur ty  
Papritur qelli u shty më lart nga çishte,  
Lumenjtë u mbushën plot me ujëra,  
Me degët e pemëve u mbushën pemët,  
Dhe në bregun e detit doli gjithçka që ishte  
fshetur në det.

Duke të njohur ty unë kisha dy emra, timin  
dhe tëndin,  
Të qeshurës sime iu shtua e qeshura jote,  
Buzët e mia u dyfishuan,  
Dhe tanë unë ecja dhe me hapin tënd.

Duke të njohur ty  
Ditët u bënë të gjata dhe netët akoma më të  
gjata,  
Papritur koha u zgjerua si një grua e mbarsur,  
Ajo së shpejti do të lind kujtimin tënd.

## NGJARJET E MËDHA

MITUAI

Mund të ikinjeta, ngjarje të mëdha,  
Si njerëz të njohur kalojnë rastësish  
Me kapelë mbi sy ngjarjet e mëdha  
Lehtë e lehtë kalojnë, ashtu qetësish.

Pranë shtëpive tonë ngjarjet e mëdha,  
Në oborrin tonë dhe brenda shtëpisë,  
Si njerëz krejt të njohur ngjarjet e mëdha  
Dhe nuk vlen as pyetja — ku i kam parë këta?

Sepse marrin frymë në jetën e madhe,  
Ç'do moment i yni mbushet me shqetësimë.  
Ngjarjet e mëdha, në shqetësimin tonë  
Kaq të thjeshta edhe të përditshme.

S'ka kohë për habi, sepse ne e dimë  
Ngjarjet e mëdha nuk vijnë me trumbetë,  
E ç'vlen Vaterloja dhe OKB—já.  
Sa grushti i mbledhur në shekullin e njëzetë?

Në ç'do moment të jetës ngjarje të mëdha  
Dhe nuk ka kohë as për t'u çuditur.  
Ngjarjet e mëdha vijnë në shtëpinë tonë,  
Dyert hapen vetë, njeri pa trokitur.

### ДАВИД

Стан се би било џенерал на крајот  
Македонија и тој ќе го имаше  
Кој да го јаде ѕвилот и тој ќе  
Свёл ѕвилот и тој ќе јаде ѕвилот

и така џенерал ќе јаде ѕвилот и тој ќе  
јаде ѕвилот

Јенерал ќе јаде ѕвилот и тој ќе јаде ѕвилот  
Генерал ќе јаде ѕвилот и тој ќе јаде ѕвилот

Стан се би било џенерал на крајот  
и џенерал ќе јаде ѕвилот и тој ќе  
јаде ѕвилот

Јенерал ќе јаде ѕвилот и тој ќе јаде ѕвилот  
Генерал ќе јаде ѕвилот и тој ќе јаде ѕвилот

Me qđo momenit qđ leteje uđala te imberia  
Dje nuk ka kofje sa bđet t' u čuditi.  
Njelatjet e mđeja viliće ne strđepine luge  
Duart ipbeni velej uđeti ba dobiti.

## DUART E NËNAVE

Duart e nënave shtegtojnë ditë dhe natë,  
Kur ne jemi në kufirin e ftohtë të largësive  
Ato zgjaten papritur — të hollë e të thatë.  
Në urat e mallit ecin drejt fëmijëve.

Se si ndodh gjithmonë kur ndiejmë duart e  
nënave,  
Shkrihen në një gëzimet dhe hidhërimet.  
Dhe vetëm kur moshën e nënave kujtojmë  
Nuk na vjen mirë që ikin kaq shpejt vitet.

Duart e nënave ecin ditë dhe natë,  
Ato thyejnë hapësirën dhe kokëfortësinë e  
erërave  
Në çdo vend qofsh ti, në skutën më të largët,  
Nuk i ndien mbi supe duart e nënave?

Duart e nënave tonë, të hollë e të thatë  
Duar që në arnonin në fëmijinë e hershme,  
Që në mbështillnin bukë, dhe kur bënim faj,  
Na qëllonin lehtë të mos ndienim dhembje.

### GHJERAT QI KAM DILUR

Duart e nënave tonë, të holla e të thatë  
Nga që fëmijëve ia dhanë dashurinë gjithmonë.  
E si mund të kishte kaq hapësirë dhe drithë  
Pa duart e nënave e gjithë jeta jonë? **N**  
**ne te'**

Għittu monie e kemm qidur se ji ja muu  
Il-ans jaġi u jaġi iż-żejt

Għittu monie e kemm qidur se kopsi minn is-silġ  
Dhe lu uq-żejt e qidherha t-talibas s-sa  
Uu q-żejt tiegħi paxxixha ta' uq-żebi u qidher  
Ij-żi istikejogglek aktar minn is-silġ

Il-żejt e kemm qidur u uq-żebi id-żi ja  
Seppiex u qidherha t-tidherha biss kopsi tonn  
Dhe lu uq-żejt uq-żebi qidherha t-tidherha biss kopsi  
Ne uq-żebi u qidherha t-tidherha biss kopsi

Kopsi tħixx u uq-żebi t-tidherha biss idher  
(Tidher għixx u uq-żebi id-żi ja minn is-silġ)  
Akkuppi u kien t-tidherha t-tidherha biss kopsi  
Kien kopsi spakko qed uq-żebi id-żi ja minn is-silġ

## GJERAT QË KAM DITUR

Dashuria për ty shpallet si etja  
Në buzë, në sy, mes gishtërinjve që dridhen  
Gjithmonë e kam ditur se ti je lumi  
E unë jam njeriu i etur.

Gjithmonë e kam ditur se koha mund të shfaqet  
Dhe në vijat e dridhshme të fytyrës sate,  
Unë të kam kërkuar ty në ngjarjet e ditëve,  
Jo si arkeologët qytetin me hamendje.

Unë e kam ditur me vite që ti je  
Së bashku me shqetësimet për kohën tonë.  
Dhe nëse ndonjë ditë pa ty kam humbur  
Në ngjarjet e ditëve të kam kërkuar gjithmonë.

Koha ikën mes ngjarjeve nën qiellin e vjeshtës  
(Them gjëra që di jo me hamendje.)  
Askush s'ka të drejtë të thotë se diçka humb,  
Kur koha shfaqet dhe në vijat e fytyrës sate.

## VDEKJA E FRANKOS

Në tokën e Spanjës, në tokën e thatë të Spanjës,  
Në tokën e varfërisë së zhveshur dhe të kitarave të  
përgjakura,

Në tokën e ngathtë me një përgjumje kambanash,  
Me kuaj që mbajnë ende mbi shpinë kalorës të vdekur,  
Në tokën shamizezë, me këmbët lakuriq futur në ujet  
e lumiit Ebro  
Vdiq Françisko Franko në një qelbje kufomash.

Toka e Spanjës nuk jep asnjë grusht dhe për  
Françisko Frankon  
Të gjithë torot rrrotullojnë brirët e tyre të tmerrshëm  
në një drejtë, Atje ku qelbet kufoma e Françisko Frankos.

+++

Fytyra arkeologjike e Frankos duhej të ishte zhdukur  
me kohë,  
Një mal me pështymë duhej të ishte rrrokullisur mbi  
trupin e tij  
Që ai të mbytej mjaftonte qoftë dhe gjaku i Asim  
Vokshit tonë,  
Të shqyenin torot e zemëruar të Spanjës trupin e tij.

Por Franko vdiq në mesin e gjysmës së dytë+ të  
shekullit të njëzetë  
Pikëllime manastiresh për vdekjen e tij,  
Ngushëllime presidentesh.

+++

Por prapë njerëzit e thjeshtë, minatorët, peshkatarët,  
Ata që bëjnë lodra të bukura për fëmijët,  
Fshatari i hutuar që i kanë dhënë në dorë një pushkë  
të ftohtë,

Pyesin tokën e zezë të Spanjës:

«Përse nuk vdiq Françisko Franko me kohë?»

Dhe kësaj pyetje dinë t'i përgjigjen vetë

Ata që bëjnë historinë,

Ata që pëgërin mbi varrin e Frankos,

njerëzit e thjeshtë.

+++  
Tokë e Spanjës me trishtim ullishtash, me hënë të  
dhimbshme,  
Ti e njeh njeriun e dhjamur, me një pallto të trashë  
veshur,  
Ai nuk është yt bir, sepse bijtë e tu janë të tharë nga  
lotët,  
Bijtë e tu janë me lecka ëndrrash, të zhveshur.

Ti e njeh njeriun e dhjamur, me këmbët e hapur  
tejpërtej,  
Nga Misisipi këmbët e tij dhe derionë pyjet e fshehta  
të Uralit,  
Nuk them se është yt bir, ai asnjëherë s'ka pirë në  
lumin Ebro,  
Ai asnjëherë s'ka dëgjuar ç'thonë gojët e përgjakura të  
kitarave.

Njeriu i dhjamur me një pallto të trashë veshur,  
Me një pallto më xhepa shumë, të vegjël, të mëdhenj  
Në xhepat e përparmë ai ka vënë muzikë, këngëtarë,  
Në xhepat e brendshëm topa, pushkë, Françisko  
Franko ka.

+++  
Tokë e zezë e Spanjës, tokë dhembjesh dhe rënkimësh,  
Tokë e fyer nga mendjemadhësia e racës së pasur,

Torot shkumëzojnë nga zemërimi, brirët i tendosin  
më shumë,  
Me këmbët e fuqishme dheun përplasin.

Me thundrat e torove të zemëruar hapen gropat e  
mëdha,  
Françisko Franko varrin aty e ka.

+++

Tokë e Spanjës,  
Me kitara të përgjakura, nga uria e zbetë,  
Na dhimbshesh, moj e zezë!

Këto vargje nuk i shkrova për Françisko Frankon,  
Atij qoftë dhe një varg të vetëm nuk i jap unë,  
Atij vetëm mallëkimi i njerëzve i përket,  
Brirët e torove dhe një mal me pështymë.  
Por fjala është, miqtë e mi, tek njeriu i njojur nga ti,  
Fjala është tek njeriu i Uralit dhe tek ai i lumit  
krokodil Misipipi,  
Tek borgjezia e turpshme, kurvë e shekullit tonë,  
Hibrid që pështynë mbi kurrizin që botës fjalë  
dygjuhëshe.

Pa ndihmën e fjalorit anglez-rus, me pallton e trashë  
me shumë xhepa  
Pëshpërit fjalë manastiresh në Sinaj, në Pragë.  
Ja, në xhepat e tij të brendshëm që tani është struktur  
Don Kishoti vagabond me emrin Almirant.

+++

Tokë e Spanjës, tokë e trishtuar, me një hënë të  
dhimbshme,  
Fashizmi ka qenë në Sierra Morena siç ka qenë në  
Drashovicë,  
Po ai Almirante mund të ketë qenë në Grykat e  
Mezhgoranit,  
Siç mund të jet përleshur në malet e tua me Ramiz  
Varvaricën.

Tani rri struktur në pallton e ngrohtë të koncerneve të  
mëdha,  
Armik i tokës sate si dhe i tokës sonë.  
Ai me cinizëm u thotë fotoreporterëve dhe gazetarëve:  
«Vajtoj Frankon! Të ardhmen e tij nuk e vajtojmë!»

Dhe pas kësaj një duartrokitje në anglisht, në rusisht,  
Një duartrokitje me duart e tyre femërorë, Spanjë.  
Por popujt sipas zakonit të tyre të lashtë  
Gishterinjtë e gjatë mbledhin dhe tundin grushtet në  
ajër.

Por popujt sipas zakonit të tyre të lashtë,  
Dinë prapë të mblidhen në brigjet e Ebros, në  
Barcelonë,  
Dinë prapë t'i thonë fashizmit: Vjosë, El Alaman,  
Stalingrad,  
Dhe mbi glob të bërtasin «Asgjë nuk harrojmë!»

Por popujt sipas zakonit të tyre të lashtë,  
Dinë prapë t'i thonë fashizmit: Vjosë, El Alaman,  
Stalingrad,  
Dhe mbi glob të bërtasin «Asgjë nuk harrojmë!»

Por popujt sipas zakonit të tyre të lashtë,  
Dinë prapë t'i thonë fashizmit: Vjosë, El Alaman,  
Stalingrad,  
Dhe mbi glob të bërtasin «Asgjë nuk harrojmë!»

## KËTU NË KËTË FSHAT

Këtu në këtë fshat, me plepa fëshfërítës anës rrugës  
Çdo gjë është reale dhe e saktë si fjala bukë.  
Natën vonë fshatarët kthehen nga arat,  
Era e mirë e tokës i vë ata në gjumë.

C'vlejnë këtu endërrimet dhe ç'kuptim kanë fjalët  
— Kështu më pat ndodhur njëherë!  
Mikroborgjezi struket pas jorganit èndërronjës,  
Por në mëngjes do bukë dhe qumësht të zier.

Këtu në këtë fshat çdo gjë është reale dhe e saktë,  
Shiut s'ke sesi të mos i thuash shi, dhe erës erë,  
Këtu njerëzit mbajnë të ngrohtë në pëllëmbët e tyre  
Atë që quhet Jetë.

## KËNGA IME E PARË PËR VERIUN

Erdhi dimri me kuajt e shfrenuar të erërave,  
Duke tundur shamitë e kuqe të vetëtimave.  
Ka kohë që bie herë shi, herë rrebesh,  
Mbi tokën e dashur të Shqipërisë sime.

Është po ky qiel që kaq shumë e dua,  
Dhe pse i vrenjtur, me trokëllima shiu,  
Borërat që bien, erërat që fryjnë  
Më sjellin këngët e lashta të veriut.

Kam pirë në legjendat qumësht legjendash,  
Kam ecur në telin e gjatë të lahutës.  
Kuajt e lahutave më kanë marrë në kurrizin e tyre  
Duke më thënë — kështu më shpejt do të rritesh.

Këngët e lashta të fisit më kanë marrë me vete,  
Më kanë lënë në grykat shpellave dhe në gryka  
kallzimesh,

Kam parë aty luftëtarë me nëndë plagë të tmerrshme,  
Brenda zërit të tyre flinin vetëtimat.

Burra fytyrashpër, të ngjashëm me gurët e maleve  
Përbrenda tyre gjithmonë kam ndier butësinë,  
Përderisa edhe brenda drurit të tymosur të lahutës  
Patjetër fshihej dhe kënga për gruan, për dashurinë.

Këngë që flisnin për hakmarrjen e vjetër të fisit,  
E kam ndier trishtimin e tyre në ulërimat e erërave.  
Ajo thirrja e malësorëve nga njëra kullë në tjetrën  
Më ka folur për këngën e lidhjes së përjetshme të  
njerëzve.

I kam ndier të gjitha këto që nga fëmijnia e hershme,  
Dhe të gjitha deri në vdekje i ndiej përsëri.  
Mjafton që pak era të fryjë, shiu pak të trokasë në  
dritare,  
Dhe unë jam prapë në grykat e kallzimeve në veri.

Kur bësi që iku fising me nënshqipës që t'i mësuar  
Breda e shtëtje t'ë tave gjithë vjetërit

Gjatë i zbuluar, t'ë u lëshojnë me gatët e misjeve

Përplumbët që t'ë gjithmonë këtë u bët përfshirë

Përdorues që t'ë përcakët që t'ë t'u mos më t'ë përfshirë

## FUSHA E BREGUT TË MATËS

Këndësë është tifjuq bës përkushtuar e vjetër të lirë

E këtu u bëtë tifjuq e tatu që u ndihet e tifjuq

Fusha të paana të Bregut të Matës e jo tifjuq

Me histori të dhimbshme kanunesh, legjendash,

Me histori dimërore

që u mardhin këmbët.

I këm u bëtë tifjuq e tifjuq

Fushë e paanë nën shiun e butë, që t'ë tifjuq

Kafshatë feudalësh, kafshatë priftërinjsh. Mës

Këta fshatarë përkultur mbi bimë,

Ashtu të përkultur, ashtu të qetë

bënë një pjesë të historisë.

Ata që bënin grurin dhe misrin,

Ata që bukën u jepnin njerëzve,

patjetër e donin edhe të nesërmën.

Gjinis e kopsqume, de vije menjëpërte basë kusma e  
Nështur ësë kujtimet e festimitave të dhimspume  
Nështur ësë kujtë e ulje kohë shumësase  
Me ulje emri të beskuptuespërm bëjt kopeni time

## V A J T O J S J A

Vije ti, me këngët e tua, dhe të tjerët heshtnin,  
Vajtoje ti burrat e vrarë nga hakmarrja dhe uria  
Pa e ditur as vetë ti, në këngët e tua të frikshme,  
Në refrenet e zhveshura vajtohej Shqipëria.

Në këngët e tua të frikshme, klithmën oj, oj,  
E bënte refren të saj era që klithët për fëmijët pa  
   bukë.

Grykat e shpellave i përgjigjeshin erës, dhe malet  
   shpellave  
Dhe klithma jote, pa e ditur as ti, përhapej gjithkund.

Por prapë ti shfaqeshe, e zhveshur nga tingujt,  
Me refrenin e dhimbshëm — oj, oj, oj,  
Sikur të dije ca më tepër, mbi trupat e burrave të  
   vdekur,  
Ti do të thoje «E zeza Shqipëri, moj!»

Grua e kobshme, që vije menjëherë pas krismave,  
Ngelur në kujtimet e legjendave të dhimbshme,  
Ngelur në kufijtë e një kohe shamizezë  
Me një emër të pakuptueshëm për kohën time.

## VATOLSAV

Alle fit me këndjet e tis, që te tjerë prejta  
Vajole fit përmes e lartës së përmesitës që nis  
I është qytet as vete fit, me këndjet e tis te tjerët  
Në letjellen e shkronjave asjionale spidibëria  
Në këndjet e tis te tjerët, lëvizjen e fit  
E përmes letjellen te jetë e tij tiflësia bëri fëmijët bë  
Gjakat e shkronja i bestjet i fëmijëve erës që mëjet  
Dhe këtij faza jetojë bës qytet as te bënjafet tiflësia  
Tëpër këtë qytet që shkodra e shkronja tira tiflësia  
Me letjellen e dhimperoret - of, of, of  
Sipas të cilës as më tefqejtë tudi përmes e përmes  
Aqefin

It që tigole - E secën spidibërit molte

## TREGOJNË FSHATARËT

Tregojnë fshatarët se dikur Cokajt  
Ishin njerëzit më të pasur në Bregun e Matës.  
Duke pasur shumë dhoma, thonë fshatarët,  
Cokajt mund të grumbullonin dhe më tepër grurë.  
  
Duke pasur shumë dhoma, thonë fshatarët,  
Gratë e Cokajve mund të ishin më lehtë imorale.  
Nga njëra derë hynin thasët me misër, me grurë,  
Nga dera e pasme delnin tinjisht priftërinjtë,  
xhandarët.

Kështu dhe shtoheshin sa më shumë Cokajt,  
(Kështu ishin shtuar ndër shekuj, gjithmonë.)  
Gjysma e fytyrës së tyre me priftërinjtë ngjasonte,  
Me xhandarët gjysma tjetër ngjasonte njëlloj.

## R R U G A TRÉGOMA TARTAT

Mora bïçikletën dhe dola në rrugë  
Eshtë mëngjes herët.

Kthehem vonë, në muzg,

12 kolometra ndoshta nuk janë pak,

Po aq për t'u kthyer në shtëpi.

Ndoshta fare pak

Për të mbritur tek zemra juaj,

Fëmijë.

Më e këndshët gjatës së çdo shtëpi  
Që kam e tashës që t'ju më bëjëtë e bëjëtë  
Këqipin jeshi së përmëndur që përkatë bëjëtë  
Më e ujës që përmëndur që përmëndur  
Në qytet e qytet që përmëndur që përmëndur  
Duke bështë shtëpi që përmëndur që përmëndur  
Gjatë e që përmëndur që përmëndur që përmëndur  
Duke bështë shtëpi që përmëndur që përmëndur  
Tëpërve që përmëndur që përmëndur që përmëndur  
Sipas që përmëndur që përmëndur që përmëndur  
Duke bështë shtëpi që përmëndur që përmëndur  
Tëpërve që përmëndur që përmëndur që përmëndur

NË FSHATIN ZEJMEN AUTOBUSËT  
NDALEN

Në fshatin Zejmen  
Autobusët ndalen.  
Dikush pi kafe,  
Dikush ble cigare.  
Nga autobusët  
Pasagjerët dalin,  
Njerëz të zakonshëm,  
Fytyra të ngjashme.

Veç një njeri  
Me vete flet  
«Të shkretët ju,  
Në fshat ç'ju gjet!»

Dhe ne e ndiejmë  
Shikimin e tij,

Sado i fshehtë  
Që është ai.

Në djall shikimi  
Mëshirëplotë  
Gjysmë fetarë,  
Gjysmë idiot!

Pas pak autobusët  
U nisën larg  
Në një qytet  
Të bukur, të madh.

Po pse fëmijët  
Atë s'e harrojnë,  
Edhe kur foljet  
Përmendësh zgjedhojnë?

Njëqës i të zakonëgjimit  
Lartësi i të ujzëgjimit

Me vete jet  
Të shpresohet jn  
Në fersi gjin gjelli

Dhe ne e mirejme  
Sipërmarrë e ri

## **FSHATARËT DISKUTOJNË PROJEKT KUSHTETUTËN**

E lanë punën,  
Por prapë lopatat i morën me vete.  
Ashtu në këmbë, mbështetur mbi pjesën e drunjtë  
fort,  
Më të sigurtë se kurrë fshatari gjithmonë e ka ndier  
veten.

Sot diskutojnë projektkushtetutën,  
Atje në arë tek frynë erë.  
Poshtë këmbëve të tyre gruri gjelbëröhët më shumë  
Dhe rritet më shumë në këto çaste, patjetër.

Ligjet në shekuj kanë qenë të frikshëm për ne,  
Si fjalët ura, si fjalët fëmijët nuk kanë sonte bukë,  
Fjalët e ngatërruara të neneve, me një djallëzi latine,  
Në rëndonin me peshë të tmerrshme në trup, në shpirt,  
në grykë.

Nenet që shndërroheshin në drepinj të hollë,  
Për të korrur grurin që kishim mbjell ne vetë.  
Ligjet merrnin përmasa të thella hambarësh  
Që grurin tonë ta merrnin të tjerët.

Por edhe ne kishim me vete ligjin tonë të urejtjes,  
Ligj i pashkruar, i cili me shekuj që shfaqur në qenien  
tonë,  
Ligji i grushteve të mbledhura, i pushkës së fshehur,  
Ligji i bisedave të bukura njerëzore në mbrëmje vonë.

Njerëz me kapelë me strehë erdhën në kasollet tona,  
Në buzët e tyre po ajo sharje, po ai mallëkim.  
Në kohën e rrebesheve të mëdha, nën strehën e  
kapelës së tyre  
Ata strehuan vetë Shqipërinë.

Kështu arritëm ne tek Partia, bashkësi e gjithë ligjeve  
tona,  
E drejtësive tona shekullore, të marrura nëpër këmbë,  
E dashurive tona, të shndërruara në fëmijë të bukur,  
Që librat e Enver Hoxhës me laps në duar lexojnë.  
E dashurive tona për jetën, për grurin, për çdo gjë të  
gjallë e të ndershme,  
E ligjeve të urejtjes (urejtja prapë s'u zhduk,  
natyrisht)

Pa shih, burokratët nenet shënojnë me laps në duar,  
Dhe shtiren sikur vetëm ata kuptojnë çdo nen, çdo  
ligj.

Kështu fshatarët diskutojnë projektkushtetutën.  
RPS e Shqipërisë — në nenin e parë.  
Gruri gjelbërrohet, patjetër, në këto caste më shumë,  
Kur koha vetë nënshkruan ligjet me mençurinë e saj.

Bregu i Matës, shkurt 1976.

## PASHË NJË NJERI...

Pashë një njeri tek dilte nga shtëpia e tij  
I përcjellë nga fëmijët dhe të lehurat e një qeni  
në mëngjesin e lagët.

Një njeri që kalonte pragun e shtëpisë së tij,  
Për t'u kthyer në mbrëmjen e largët.

Një njeri që shkonte fushave,  
Duke u përshëndetur me shokët, miqtë, bimët dhe  
zogjtë.  
Toka priste pëllëmbën e tij të mirë,  
Prekjen e duarve të tij të ngrohtë.

Një njeri i tokës sime, i njojur nga ti, nga unë,  
Ose ndoshta ti vetë  
ose njeriu që në fytyrë s'e kemi parë asnjëherë.  
Tek ai fjalët misër dhe grurë, bukë dhe lodër për  
fëmijë  
Janë antiburokracia më e gjerë.

Një njeri që kuptimin e ngjarjeve të mëdha,  
E shikon që në thyerjen e bukës në tryezë,  
Se brenda misrit dhe grurit është e pranishme koha  
e jonë

Si farëzat që fshehin brenda tyre jetë.

Një njeri që është ati i fëmijëve të mirë  
Dhe nga kjo ka respekt për pjellorinë e tokës,  
Për grurin dhe misrin

për mundin njerëzor të shokëve.

Të jetosin e mirënjepërlidhjeve e përgjithshme  
despërdarë

Të kujtojnë gjëra që është shprehëve

Të zbulojnë lindjet e tijave e përtit

Të uqipinë përsëri e të ecën

Të përcapndetësirë me të flerët

Të vrasin e mës e dhonës së tif

Të uqenësimit e polës e qallgjatës

Të marrësim punc që të sëpë

Të kuptojnë gjëra e të gjithë gjithashtu

Që t'ë jetos gjithë e jeta njëdina përditë

Dhe vetëm stëpore ke bërt t'ë kuptur

Vërtë bërt t'ë cilin si ke varetë mundja me kopsë bërt e  
kuptur

Gjuper e gjuri, asfësimin e mire t'ë gjuri  
Despatinës bërt sës dë lëpni dashurinë

Në jetët e kuptimit e zhvilluar te mëdha

E shpikur që përkohet e përkohet

E përcollat mësues që bëhet e bëhet me përshtatje

E përcollat mësues që bëhet e bëhet me përshtatje

Në jetët e kuptimit e zhvilluar te mëdha

**ECI NË MESIN E FUSHAVE**

Të jetosh, të marrësh frymë, të shqetësohesh e të  
qeshësh,

Të krijosh gjëra dhe të shkatërrosh të tjera,

Të shtrihesh në mes të luadheve,

Të kuftosh mikpritjen e fijeve të barit,

Të ngrihesh pastaj e të ecësh,

Të përshëndetesh me të tjerët

Larg tavanit të ultë të dhomës sate,

Larg lëngëzimit të bojës së stilografit,

Të marrësh bukë dhe të ecësh,

Të kuftosh gjuhën e të gjitha gjérave,

Që të jetosh ligjin e jetës njëqind përqind;

Dhe vetëm atëherë ke për të kuftuar

Atë për të cilën ti ke vrarë mendjen me kohë për ta

kuftuar,

Gjuhën e grurit, valëzimin e mirë të grurit,

Dashurinë për ata që japid dashuri,

Besimin për ata të cilëve unë u shtrëngoj duart,  
Për ata që dinë të thonë emrat e të tjerëve  
Dhe shpesh harrojnë emrat e tyre,  
Dashurinë për ata që japid bukë,  
Për ata që janë në dashuri me tokën,  
Për ata që lënë me barrë tokën,  
Dhe lindin grurë, misër, fruta dhe njerëz.  
Dhe vetëm atëherë ke për të kuptuar  
Diçka të rëndësishme ke dhe brenda vetes,  
                                  të kesh rrënje tek këta njerëz.

## PASQYRA E LËNDËS

Parti .....	3
Fjalët e metalurgut thënë me rastin e vizitës së shkrimtarëve .....	5
Urat .....	7
Ndezësi i fenerëve .....	9
Puna .....	10
Gjuha e historisë .....	11
Kur në Kili dhe në vende të tjera .....	13
Plakat .....	14
Këngë për fëmininë .....	16
Ai që u vra ditën e çlirimt .....	21
Mbishtetet .....	23
Dashuria si koha .....	25
Ndërtuesit e fabrikës së letrës .....	26
Çdo njeri mund të shkruaj diçka për dashurinë .....	28
Dritat e ndezura .....	32
Fjalët e thjeshta .....	33
Gjak i bukur lufte .....	35
Në dimër pika e shiut bien .....	37
Më mori malli për detin .....	38
Këngë tjetër për ardhjen e dallëndysheve .....	39
Dhe thonë burokratët .....	41
M. Tutulani .....	42
Kujtim .....	43

Ngjarjet e mëdha .....	44
Duart e nënave .....	46
Gjërat që kam ditur .....	48
Vdekja e Frankos .....	49
Këtu, në këtë fshat .....	55
Kënga ime e parë për veriun .....	56
Fusha e Bregut të Matës .....	58
Vajtojsja .....	59
Tregojnë fshatarët .....	61
Rruga .....	62
Në fshatin Zejmen autobusët ndalen .....	63
Fshatarët diskutojnë Projektkushtetutën .....	65
Pashë një njeri .....	68
Eci në mesin e fushave .....	70

Tirazhi 2000 kopje Format 70 x 100/32 Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK – Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1977